

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

RIPARIM I PAJISJEVE
ELEKTROSHTËPIAKE

Niveli II

(Në drejtimin mësimor ELEKTROTEKNIK)

Kodi: E3-II-11

Miratoi:

MINISTRI

MYQEREM TAJAJ

Tiranë, 2011



Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, të drejtimit mësimor “Elektroteknik”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II.
- III. Plani mësimor për profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, të drejtimit “Elektroteknik”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, të drejtimit “Elektroteknik”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Elektroteknik”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASH përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në punimet e riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të zbatojë standartet teknike
- Të riparojë sobën elektrike
- Të riparojë mikrovalën
- Të riparojë fshesën me korent
- Të riparojë pajisje të vogla elektroshtëpiake (shtrydhëse, mikser).
- Të riparojë makinën larëse të rrobave
- Të riparojë makinën tharëse të rrobave
- Të riparojë makinën larëse të enëve.
- Të riparojë frigoriferin shtëpiak
- Të montojë dhe mirëmbajë aspiratorët
- Të riparojë ekspresin e kafesë
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës
- Të kryejë saktë veprimet kryesore për të dhënë ndihmën e shpejtë
- Të zbatojë standardet e profesionit gjatë kryerjes së punimeve
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë e të mbrojtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në të gjitha bizneset që disponojnë pajisje elektroshtëpiake, në pikat e tregëtimit të tyre, në pika servisi të pajisjeve elektroshtëpiake dhe elektromekanike, si dhe në veprimtari të tjera që veprojnë në drejtimin e elektroteknikës. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake..

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “maturës profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II

| Plani mësimor për profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II | | | |
|---|-------------|--|---------------------------|
| Nr | Kodi | Lëndët dhe modulet mësimore | Orët javore/ vjetore |
| | | | Klasa 12 |
| A. | | Lëndët e përgjithshme (Gjithsej) | 8/10 (272/340) |
| 1 | | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 2 |
| 2 | | Gjuhë e huaj | 2 |
| 3 | | Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë) | (2) |
| 4 | | Matematikë | 2 |
| 5 | | Teknologji informimi e komunikimi | 1 |
| 6 | | Aftësi për jetën | 1 |
| B. | | Lëndët profesionale (Gjithsej) | 7 (238) |
| 1 | L-17-157-10 | Bazat e sipërmarrjes | 2 |
| 2 | L-11-212-11 | Makinat elektrike | 2 |
| 3 | L-12-213-11 | Elektronikë industriale | 2 |
| 4 | L-11-214-11 | Teknikë sigurimi në riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake | 1 |
| C. | | Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej) | 12 (408) |
| 1 | M-11-586-11 | Riparimi i sobës elektrike dhe i mikrovalës | 51 |
| 2 | M-11-587-11 | Riparimi i pajisjeve të vogla elektroshtëpiake | 85 |
| 3 | M-11-588-11 | Riparimi i makinës larëse të rrobave | 85 |
| 4 | M-11-589-11 | Riparimi i makinës tharëse të rrobave | 51 |
| 5 | M-11-590-11 | Riparimi i makinës larëse të enëve | 51 |

| | | | |
|-----------|-------------|--|--------------------------|
| 6 | M-11-591-11 | Riparimi i frigoriferit shtëpiak | 51 |
| 7 | M-11-592-11 | Riparimi i hekurit profesional | 34 |
| D. | | Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej) | 3 (102) |
| 1 | M-11-593-11 | Riparimi i makinës larëse industriale të rrobave | 51 |
| 2 | M-11-594-11 | Riparimi i frigoriferit industrial | 51 |
| 3 | M-11-595-11 | Montimi dhe mirëmbajtja e kondicionerit | 102 |
| | | Gjithsej A+B+C+D | 30/32 (1020/1088) |

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit.

Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II. Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”. Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehjeve, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Riparim pajisjesh elektroshtëpiake”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Çertifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MASH, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi në:
 - lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - dy provimet përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementet kryesore të saj.
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore.
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes.
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes.
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të.
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje.
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes.
- Të shpjegojnë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre.
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut.
- Të listojnë katër *P*-të e marketingut.
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës.
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

| | | |
|----------------|--|--------|
| Tema 1 | Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen | 3 orë |
| Tema 2 | Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor | 4 orë |
| Tema 3 | Sipërmarrja dhe biznesi | 8 orë |
| Tema 4 | Organizimi i punës në biznes | 9 orë |
| Tema 5 | Tregu dhe sjellja konsumatore | 6 orë |
| Tema 6 | Institucionet financiare | 7 orë |
| Tema 7 | Njohuri për Marketingun | 5 orë |
| Tema 8 | Legjislacioni dhe etika e biznesit | 5 orë |
| Tema 9 | Legjislacioni i punës | 7 orë |
| Tema 10 | Llogaritje të thjeshta ekonomike | 10 orë |
| Tema 11 | Aspekte të TIK-ut në biznes | 4 orë |

2. Lënda “Makinat elektrike” (L-11-212-11). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Makinat elektrike”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Makinat elektrike”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë ndërtimin dhe parimin e punës së motorëve elektrikë të tipeve të ndryshëm
- Të dallojnë veçoritë e motorëve elektrikë të tipeve të ndryshëm
- Të analizojnë ligjet mekanike të transmisioneve elektrike.



- Të analizojnë vetitë elektromekanike të tipeve të ndryshme të motorëve elektrikë
- Të paraqitin grafikisht tipe të ndryshme të motorëve elektrikë
- Të shpjegojnë mënyrat e nisjes dhe rregullimit të shpejtësisë së motorëve elektrike të tipeve të ndryshme.
- Të shpjegojnë mënyrat e frenimit elektrik sipas tipit të motorit.
- Të tregojnë tipet dhe veçoritë e pajisjeve komutuese
- Të vizatojnë skema të ndryshme komandimi të pajisjeve elektrike ionit
- Të analizojnë skema të ndryshme komandimi të pajisjeve elektrike ionit

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Makinat elektrike”, kl. 12- 68 orë:**

| | | |
|---------------|--|--------|
| Tema 1 | Shfrytëzimi, defektet dhe remonti i makinave elektrike | 10 orë |
| Tema 2 | Mekanika e transmisioneve elektrike dhe vetitë elektromekanike të motorëve elektrike | 8 orë |
| Tema 3 | Nisja dhe rregullimi i shpejtësisë së motorëve elektrikë | 15 orë |
| Tema 4 | Regjimet e frenimit elektrik për tipe të ndryshëm motorësh elektrikë | 9 orë |
| Tema 5 | Njohuri mbi aparatet e komutimit | 12 orë |
| Tema 6 | Skemat e komandimit të motorëve elektrikë | 14 orë |

3. Lënda “Elektronikë industriale” (L-12-213-11). Kl. 12 - 68 orë

• **Synimet e lëndës “Elektronikë industriale”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Elektronikë industriale”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë parimin e punës të përforcuesve të tipeve të ndryshme
- Të përcaktojnë llojin e përforcuesit në bazë të skemës
- Të listojnë veçoritë e secilit përforcues
- Të shpjegojnë parimin dhe kushtet e gjenerimit.
- Të shpjegojnë ndryshimet ndërmjet gjeneratorit dhe përforcuesit
- Të listojnë tipet e gjeneratorëve.
- Të shpjegojnë funksionimin e portave të thjeshta logjike
- Të lexojnë skemat e drejtuesve industrialë .
- Të tregojnë rolin e burimeve të ushqimit në qarqet elektrike.
- Të analizojnë skema të ndryshme ushqyesish.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Elektronikë industriale”, kl.12- 68 orë**

| | | |
|---------------|---|--------|
| Tema 1 | Përforcuesit me tranzistor dhe me qarqe të integruara | 12 orë |
| Tema 2 | Qarqet impulsive | 14 orë |
| Tema 3 | Qarqet logjike | 18 orë |
| Tema 4 | Skemat e komandimit me Tiristor, Triak, TNjK, CMOS | 8 orë |
| Tema 5 | Burimet e ushqimit me fuqi të vogël, mesme, të madhe me ventila të komandueshëm | 10 orë |
| Tema 6 | Fotoelementet dhe piezoelektriciteti | 6 ore |



**4. Lënda “Teknikë sigurimi në riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake” (L-11-214-11).
Kl. 12 - 34 orë**

- **Synimet e lëndës “Teknikë sigurimi në riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë sigurimi në riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë veprimin e rrymës elektrike në trupin e njeriut
- Të tregojnë llojet e mjeteve mbrojtëse dhe rolin e tyre
- Të analizojnë mundësitë e dëmtimit nga rryma elektrike
- Të shpjegojnë masat e përgjithëshme të mbrojtjes në instalimet elektrike.
- Të analizojnë rolin e tokëzimit mbrojtës dhe kushtet e realizimit të tij.
- Të analizojnë rolin e neutrizimit mbrojtës dhe kushtet e realizimit të tij.
- Të përshkruajnë masat mbrojtëse në instalimet elektrike të ndërmarrjeve industriale.
- Të japin ndihmën e parë të goditurve nga rryma elektrike

- **Përmbajtjet e përgjithëshme të lëndës “Teknikë sigurimi në riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake”, kl.12 - 34 orë**

| | | |
|---------------|---|-------|
| Tema 1 | Veprimi i rrymës elektrike në organizmin e njeriut.Mjetet mbrojtëse | 3 orë |
| Tema 2 | Kushtet e dëmtimit nga rryma elektrike | 5 orë |
| Tema 3 | Masat e përgjithëshme të mbrojtjes në instalimet elektrike | 5 orë |
| Tema 4 | Tokëzimi mbrojtës | 6 orë |
| Tema 5 | Neutrizimi mbrojtës | 6 orë |
| Tema 6 | Masat mbrojtëse në instalimet elektrike të ndërmarrjeve industriale | 5 orë |
| Tema 7 | Dhënia e ndihmës së parë të goditurve nga rryma elektrike | 4 orë |

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli “Riparimi i sobës elektrike dhe i mikrovalës”

Drejtimi: Elektroteknik
Profili: Riparim pajisjesh elektroshtëpiake
Niveli: II
Klasa: 12

| <i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|---|--------------------|
| Titulli dhe kod | RIPARIMI I SOBËS ELEKTRIKE DHE I MIKROVALËS | M-11-586-11 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të bërë riparimin e plitkave të pianturës dhe të furrës së sobave elektrike si edhe për të përcaktuar defektet e mikrovalës dhe për të zëvendësuar ose riparuar elementet e dëmtuara të saj. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 51 orë mësimore | |
| Niveli i parapëlqyer për praninë | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Elektroteknik”. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi riparon plitkat e pianturës së sobës elektrike. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës sipas standarteve.- Vizatimi i skemës funksionale të plitkës dhe përcaktimi i elementeve.- Kontrolli i rezistencës dhe izolacionit të plitkave me avometër.- Evidentimi i defektit- Çmontimi i plitkave të dëmtuara- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar- Montimi i plitkave të reja- Kontrolli i plitkave pa tension .- Kontrolli i plitkave me tension- Evidentimi i gabimeve të mundëshme- Korrigjimi i gabimeve të mundëshme- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës- Pastrimi i vendit të punës në përfundim të saj Instrumentet e vlerësimit: | |



-
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e plitkës
- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të vizatojë skemën e lidhjes së plitkave dhe të përcaktojë elementet e saj
- të kontrollojë rezistencën dhe izolacionin e plitkave me avometër
- të evidentojë defektin
- të çmontojë plitkat e dëmtuara
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të montojë plitkat e reja duke zbatuar kushtet teknike
- të kontrollojë plitkat e zëvendësuara me avometër
- të kontrollojë plitkat të zëvendësuara me tension
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të korrigjojë gabimet e mundshme
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj.

RM 2 Nxënësi ndërron çelsat e pianturës së sobës elektrike.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës sipas standarteve.
- Përdorimi i veglave dhe pajisjeve për ndërrimin e çelsave të pianturës
- Vizatimi skemës së lidhjes së çelsave.
- Kontrolli i çelsave me avometër.
- Çmontimi i çelsave të dëmtuar.
- Montimi i çelsave të rinj sipas kushteve teknike
- Kontrolli i lidhjes së çelsave pa tension .
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Kontrolli i çelsave të montuar me tension.
- Evidentimi i gabimeve të mundshme.
- Korrigjimi i gabimeve të mundshme.
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- Pastrimi i vendit të punës në përfundim të saj

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për realizimin e instalimit të ndricimit nga dy pika.



- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të përdorë drejt veglat dhe pajisjet për ndërrimin e çelsave të pianturës
- të vizatojë skemën e lidhjes së çelsave
- të kontrollojë çelsat me avometër
- të çmontojë çelsat e dëmtuar
- të montojë çelsat e rinj duke zbatuar kushtet teknike
- të bëjë kontrollin e çelsave të zëvendësuar me avometër
- të bëjë kontrollin e çelsave të zëvendësuar me tension
- të hartojë preventivin për materiale sipas defektit të përcaktuar
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korrigjimin e gabimeve të mundshme
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- të pastrojë vendin e punës

RM 3 Nxënësi riparon furrën elektrike të sobës elektrike

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës sipas standarteve.
- Përdorimi i veglave dhe pajisjeve për riparimin sobës elektrike
- Kontrolli i rezistencave të furrës me avometër
- Çmontimi i rezistencave të djegura.
- Montimi i rezistencave të reja sipas kushteve teknike
- Kontrolli i çelsave të furrës
- Ndërrimi i çelsave të dëmtuar
- Kontrolli i termostatit
- Ndërrimi termostatit.
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Kontrolli pa tension i elementëve të zëvendësuar .
- Kontrolli me tension i elementëve të zëvendësuar.
- Evidentimi i gabimeve të mundshme.
- Korrigjimi i gabimeve të mundshme.
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjatë punës
- Pastrimi i vendit të punës në përfundim të saj

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin e sobës elektrike



- të përdorë drejt veglat dhe pajisjet për riparimin sobës elektrike
- të çmontojë rezistencat e dëmtuara
- të vendosë rezistencat e reja sipas kushteve teknike
- të kontrollojë çelsat me avometër
- të ndërrojë çelësat e dëmtuar
- të kontrollojë termostatin
- të ndërrojë termostatin
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të bëjë kontrollin pa tension të pajisjeve të ndëruara
- të bëjë kontrollin me tension të pajisjeve të ndruara
- të evidentojë gabimet e mundshme
- të bëjë korrigjimin e gabimeve të mundshme
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të mirëmbajë vendin e punës.

RM 4 Nxënësi ndërron çelsat rrugorë dhe fundorë të mikrovalës

Përmbajtja

- Përzgjedhja e materialeve dhe veglave të punës për ndërrimin e çelsave rrugorë dhe fundorë
- Analiza e skemës dhe evidentimi i elementeve të mikrovalës
- Kontrolli i viziv i qarkut të ushqimit
- Kontrolli me avometër i qarkut të ushqimit
- Riparimi i defekteve të mundëshme
- Kontrolli viziv i çelsave rrugorë dhe fundorë
- Kontrolli me aparat i çelsave rrugorë dhe fundorë
- Çmontimi i çelsave zgjedhja e çelsave të rinj
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Montimi i çelsave sipas kushteve teknike
- Kontrolli i lidhjes së çelsave pa tension
- Kontrolli i lidhjes së çelsave me tension
- Evidentimi i gabimeve të mundëshme
- Korrigjimi i gabimeve të mundëshme
- Korrigjimi i gabimeve të mundshme që mund të ndodhin
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit
- Pastrimi i vendit të punës

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës sipas standarteve



- të hartojë preventivin për materialet që nevojiten
- të analizojë skemën e mikrovalës dhe të evidentojë elementet e saj
- të kontrollojë çelsat me sy dhe me avometër
- të çmontojë çelsat e dëmtuar
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të zgjedhë çelsat e rinj sipas standarteve teknike
- të montojë çelsat e rinj duke zbatuar kushtet teknike
- të bëjë kontrollin e çelsave të zëvendësuar me avometër
- të bëjë kontrollin e çelsave të zëvendësuar me tension
- të evidentojë ndonje gabim të mundshëm
- të bëjë korrigjimin e gabimeve të mundshme
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik
- të pastrojë vendin e punës në përfundim të saj
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë
- të pastrojë vendin e punës

RM 5 Nxënësi riparon qarkun elektronik të mikrovalës

Përmbajtja

- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe materialeve të punës.
- Analiza e skemës elektronike.
- Kontrolli i siguresave me avometër.
- Kontrolli i rezistencave
- Kontrolli i diodave
- Zmontimi i tranzistorëve
- Kontrolli i transformatorit të tensionit të lartë(2-3KV)
- Kontrolli viziv i magnetronit
- Heqja e pjesëve të dëmtuara
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Zgjedhja e pjesëve të reja
- Montimi i pjesëve të reja
- Kontrolli i lidhjes së pjesëve të ndëruara pa tension .
- Kontrolli i lidhjes së pjesëve të dëmtuara me tension.
- Evidentimi i gabimeve të mundshme.
- Korrigjimi i gabimeve të mundshme.
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës sipas



standarteve.

- të hartojë preventivin për materialet e nevojshme
- të analizoje skemen elektronike të mikrovalës.
- të kontrollojë siguresat me avometër.
- të kontrollojë rezistencat me avometër
- të kontrollojë diodat me avometër
- të zmontojë tranzistorët me avometër
- të kontrollojë transformatorin e tensionit të lartë(2-3KV)
- të kontrollojë në mënyrë vizive magnetronin
- të heqë pjesët e demtuara
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të zgjedhë e pjesët e reja sipas standarteve
- të montojë pjesët e reja sipas kushteve teknike
- të kontrollojë lidhjen e pjesëve të ndruara pa tension .
- të kontrollojë lidhjen e pjesëve të demtuara me tension.
- të evidentojë gabimet e mundëshme.
- të korrigjojë gabimet e mundëshme.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në pika servisi të pajisjeve elektroshtepike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për përdorimin e veglave dhe të instrumenteve matëse për kontrollin e elementeve të ndryshme të shtabëve elektrike dhe të mikrovalës.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisit për kryerjen e riparimeve;
 - Veglat dhe aparatet e nevojshme e nevojshme për kontrollin dhe zëvendësimin e elementeve të vecanta të pajisjes;
 - Materiale pune si: piantura, furra elektrike, plitka çelësa, termostate, mikrovalë, etj.
 - Udhëzuesat, rregulloret, manuale teknike, fatura financiare, etj.
-



2. Moduli “Riparimi i pajisjeve të vogla elektroshtëpiake”

Drejtimi: Elektroteknik
Profili: Riparim pajisjesh elektroshtëpiake
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

| | | |
|--|---|--------------------|
| Titulli dhe kodi | RIPARIMI I PAJISJEVE TË VOGLA ELEKTROSHTËPIAKE | M-11-587-11 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të kryer kontrollin e pjesëve e pajisjeve të vogla elektroshtëpiake (shtrydhësit të frutave, mikserit, fshesës me korent, aspiratorit, hekurit profesional) dhe evidentimin e defekteve në to si edhe për të bërë zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara me pjesë të reja ose riparimin e tyre. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 85 orë mësimore | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Elektroteknik”. | |

| | |
|--|---|
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi riparon shtrydhësin e frutave Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës- Analiza e skemes dhe evidentimi i elementeve të shtrydhëses së frutave.- Kontrolli i qarkut të ushqimit- Riparimi i defekteve të mundëshme- Kontrolli i çelsave të komandimit- Ndërrimi i tyre- Pastrimi i tyre kur është e nevojshme- Kontrolli i çelsave fundorë- Pastrimi ose ndërrimi i tyre- Kontrolli i karboncinave të motorit- Pastrimi, tarimi dhe zëvendësimi i karboncinave të motorit.- Kontrolli i kolektorit dhe pastrimi i tij.- Kontrolli i kuzhinave të motorit për ndonjë bllokim mekanik- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar- Riparimi i defektit- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të shtrydhësit të frutave. Instrumentet e vlerësimit: |
|--|---|



– Pyetje-përgjigje me gojë

Kriteret e vlerësimit:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- të përzgjedhe mjetet dhe materialet e punës sipas standardeve
- të hartojë preventivin për materiale
- të analizojë skemen e shtrydhësit të frutave dhe të evidentojë elementet e saj;
- të kontrollojë qarkun e ushqimit me sy dhe me avometer;
- të riparojë defektet e mundshme në qarkun e ushqimit;
- të kontrollojë çelësat e komandimit
- të pastroje ose ndërrojë çelësat e komandimit sipas kushteve teknike
- të kontrollojë çelësat fundorë
- të pastrojë ose ndërrojë çelësat fundorë sipas kushteve teknike;
- të kontrollojë karbonçinat
- të bëjë pastrimin, tarimin ose zëvendësimin e tyre sipas rastit
- të kontrollojë kolektorin dhe të bëjë pastrimin e tij n.q.s. është e nevojshme
- të kontrollojë kuzhinetat e motorit për ndonjë bllokim mekanik
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të eliminojë problemin.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të shtrydhësit të frutave

RM 2 Nxënësi riparon mikserin.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës
- Analiza e skemes dhe evidentimi i elementeve të mikserit.
- Kontrolli i qarkut të ushqimit
- Riparimi i defekteve të mundshme
- Kontrolli i çelësve të komandimit
- Zëvendësimi i çelësve të komandimit
- Pastrimi i tyre kur është e nevojshme
- Kontrolli i çelësve fundorë
- Pastrimi ose ndërimi i tyre
- Kontrolli i karbonçinave të motorit
- Pastrimi, tarimi dhe zëvendësimi i tyre.
- Kontrolli i kolektorit dhe pastrimi i tij.
- Kontrolli i kuzhinetave të motorit nga ndonjë bllokim mekanik
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të



- përcaktuar
- Eliminimi i problemit
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhe mjetet dhe materialet e punës sipas standardeve
- të hartojë preventivin për materiale
- të analizoje skemen e mikserit dhe të evidentojë elementet e tij
- të kontrollojë qarkun e ushqimit me sy dhe me avometer
- të riparojë defektet e mundshme në qarkun e ushqimit
- të kontrollojë çelsat e komandimit
- të pastrojë ose ndërrojë çelsat e komandimit sipas kushteve teknike
- të kontrollojë çelsat fundorë
- të pastrojë ose ndërrojë çelsat fundorë sipas kushteve teknike
- të kontrollojë karbonçinat
- të bëjë pastrimin, tarimin ose zëvendësimin e tyre sipas rastit
- të kontrollojë kolektorin dhe të bëjë pastrimin e tij nëse është e nevojshme
- të kontrollojë kuzhinetat e motorit nga ndonjë bllokim mekanik
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të eliminojë problemin.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit

RM 3 Nxënësi riparon elementet e dëmtuar të fshesës me korent

Përmbajtja

- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës për riparimin e elementeve të fshesës me korent
- Hartimi i preventivit për materiale
- Analiza e skemes dhe evidentimi i elementeve të fshesës me korent .
- Kontrolli i qarkut të ushqimit
- Riparimi i defekteve të mundshme



- Kontrolli i kontakteve të tamburit.
- Pastrimi i tyre
- Kontrolli i gjendjes se kuzhinetave
- Ndërrimi i kuzhinetave
- Kontrolli i qarkut elektronik
- Riparimi i qarkut elektronik
- Ndërrimi i paketës elektronike
- Kontrolli i potenciometrit
- Ndërrimi i potenciometrit
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Kontrolli i lidhjeve pa tension .
- Kontrolli i lidhjeve me tension
- Evidentimi i gabimeve të mundëshme
- Korrigjimi i gabimeve të mundëshme
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit
- Zbatimi i standarteve kombëtare për instalimin e një sinjalizimi

Instrumentat e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhe mjetet dhe materialet e punes sipas standardeve
- të hartojë preventivin për materiale
- të analizoje skemen e fsheses me koret dhe të evidentojë elementet e saj
- të kontrollojë qarkun e ushqimit me sy dhe me avometer
- të riparojë defektet e mundeshme ne qarkun e ushqimit
- të kontrollojë kontaktet e tamburit
- të pastroje kontaktet e tamburit
- të kontrollojë gjendjen e kuzhinetave
- të ndërrojë kuzhinetat
- të kontrollojë qarkun elektronik
- të riparojë qarkun elektronik
- të ndërrojë paketën elekttronike
- të kontrollojë paketën elektronike
- të kontrollojë potenciometrin
- të hartojë preventivin per materialet ne bazë te defektit te përcaktuar
- të ndërrojë potenciometrin duke zbatuar kushtet teknike
- të bëjë kontrollin e elementeve te zevendesuar me avometer
- të kontrollojë elementet e zëvendësuar me tension
- të evidentojë ndonje gabim të mundshëm
- të korrigjojë gabimet e mundshme



- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit
- të zbatojë standartet ndërkombetare për instalimin e sinjalizimit .

RM 4 Nxënësi riparon motorin elektrik të fshesës me korrent.

Përmbajtja

- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës për riparimin e motorit të fshesës me korrent
- Analiza e tipit të motorit
- Evidentimi i defekteve që mund të ndodhin në motor
- Kontrolli i karboncinave të motorit
- Pastrimi dhe ndrimi i karboncinave.
- Kontrolli i kolektorit të motorit.
- Riparimi i defekteve në kolektor.
- Kontrolli dhe matja e rotorit
- Riparim n.q.s është e mundur.
- Heqja e motorit nëse është i djegur.
- Matja e sasisë së lageshtirës së motorit
- Tharja e motorit
- Matja me megaohmetër e izolacionit të pështjellave
- Prova e rotorit me kolektor dhe evidentimi i defektit në bankoprovë
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Zevendesimi i motorit duke zbatuar kushtet teknike.
- Evidentimi i gabimeve të mundshme.
- Korrigjimi i gabimeve të mundshme.
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhe e mjetet dhe e materialet e punës sipas standarteve.
- të hartojë preventivin për materiale
- të analizoje tipin e motorit të fshesës me korrent
- të përcaktojë defektet e mundshme në motor;
- të kontrollojë karboncinat
- të pastrojë dhe të ndrojë karboncinat
- të kontrollojë kolektorin e motorit
- të bëjë riparimet e mundshme në kolektor
- të cmontojë motorin nëse është i djegur
- të masë sasinë e lageshtirës së motorit



- të bëjë tharjen e motorrit
- të masë me megaohmetër izolacionin e pështjellave
- të bëjë provën e rotorit me kolektor dhe evidentimin e defektit ne bankoprove
- të hartojë preventivin per materialet ne bazë te defektit te përcaktuar
- te zevendesojemotorin duke zbatuar kushtet teknike
- te evidentoje gabimet e mundëshme.
- te korrigoje gabimet e mundëshme.
- të përgatitë faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

RM 5 Nxënësi monton dhe riparon aspiratorin.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës. Percaktimi i vendit ku do te vendoset aspiratori
- Hartimi i preventivit për materiale
- Fiksimi i aspiratorit
- Lidhja e aspiratorit me burimin e ushqimit.
- Analiza e skemes dhe evidentimi i elementeve te aspiratorit .
- Kontrolli i qarkut te ushqimit
- Riparimi i defekteve te mundeshme
- Kontrolli i peshtjellave te motorit asinkron me avometer.
- Matja e sasise së lagështirës së motorrit
- Tharja e motorrit
- Matja me megaohmetër e izolacionit të pështjellave
- Prova e rotorit me kolektor dhe evidentimi i defektit ne bankoprove
- Kontrolli i çelësit të ndriçimit
- Kontrolli i çelsave të ndërrimit të shpejtësisë.
- Zëvendësimi i çelsave
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit te përcaktuar
- Kontrolli i punumeve te kryera
- Evidentimi i gabimeve të mundëshme
- Korrigjimi i gabimeve të mundëshme
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik gjate punës
- Pastrimi i vendit te punës në përfundim të saj
- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Zbatimi i rregullave te sigurimit tekik dhe mbrojtjes se mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:



Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhe mjetet dhe materialet e punës sipas standarteve të përcaktoje vendin ku do të montoje aspiratorin
- të fiksoje aspiratorin
- të lidhe aspiratorin me burimin e ushqimit
- të hartojë preventivin për materialet
- të analizoje skemën dhe të evidentojë elementet e aspiratorit.
- të kontrollojë qarkun e ushqimit me aparat dhe me sy;
- të riparojë defektet e mundshme të qarkut të ushqimit
- të kontrollojë peshtjellat e motorit asinkron
- të masë sasinë e lageshtirës së motorit
- të bëjë tharjen e motorit
- të masë me megaohmetër izolacionin e pështjellave
- të bëjë proven e rotorit me kolektor dhe evidentimin e defektit në bankoprove
- të bëjë zëvendësimin e motorit asinkron sipas kushteve teknike
- të kontrollojë celesin e ndricimit
- të kontrollojë celesat e ndryshimit të shpejtesisë
- të zëvendësojë celesat sipas kushteve teknike
- të bëjë kontrollin e elementeve të zëvendësuar me avometer
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të bëjë kontrollin e elementeve të zëvendësuar me tension
- të evidentojë ndonjë gabim të mundshëm
- të bëjë korigjimin e gabimeve të mundshme të përgatitës faturën për shërbimin e kryer
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale me klientin
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

RM 6 Nxënësi riparon ekspresin e kafesë

Përmbajtja

- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës sipas standarteve.
- Analiza e skemës elektrike të ekspresit të kafesë
- Zmontimi i ekspresit të kafesë
- Kontrolli i qarkut të ushqimit të ekspresit të kafesë
- Kontrolli i rezistencës me aparat.
- Matja e bobinave të elektrovalvulave
- Përcaktimi i defektit
- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të përcaktuar
- Riparimi i defekteve në qarkun elektrik të ushqimit të ekspresit të kafesë
- Zëvendësimi i rezistencës së ekspresit



- Zëvendësimi i bobinave të elektrovalvulave
- Kontrolli i punimeve të kryera
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jete i afte :

- të përzgjedhe mjetet e materialet e punës sipas standarteve
- të analizojë me kujdes skemën elektrike të ekspresit të kafesë
- të kryejë zmontimin e ekspresit të kafesë
- të kontrollojë qarkun e ushqimit duke kryer matjet e duhura
- të kontrollojë rezistencën me aparat;
- të masë bobinat elektrovalvulave
- të përcaktojë defektin
- të hartojë preventivin për materialet në bazë të defektit të përcaktuar
- të riparojë defektet në qarkun e ushqimit të ekspresit të kafesë
- të zëvendësojë rezistencën me aparat
- të zëvendësojë bobinat e elektrovalvulave
- të kontrollojë punimet e kryera
- të evidentojë gabimet e mundshme
- të bejë korigjimin e gabimeve të mundshme
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose në pika servisi të pajisjeve elektroshtepike.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për përdorimin e veglave dhe të instrumenteve të matjes për kontrollin dhe ndërrimin e pjesëve të ndryshme të shtrydhësit të frutave mikserit, fshesës me korent, ekspresit të kafesë dhe aspiratorit..
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedisi për kryerjen e riparimeve;
- Veglat dhe aparatet e nevojshme e nevojshme për kontrollin dhe zëvendësimin e elementeve të vecanta të pajisjeve elektroshtepike;

-
- Materiale pune si: shtrydhese frutash,mikser ,fshese me korent,ekspres kafeje,aspirator dhe pjese nderrimi për to.
 - Materiale te shkruara si skema, rregullore, manuale, udhezuesa, etj.
 - Materiale ilustruese (pankarta, transparente, makete etj.)
 - Manualet e preventivit,fatura.
-

3. Moduli “Riparimi i makinës larëse të rrobave”

Drejtimi: Elektroteknik
Profili: Riparim pajisjesh elektroshtëpiake
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

| Titulli dhe kod | RIPARIMI I MAKINËS LARËSE TË RROBAVE | M-11-588-11 |
|---|---|-------------|
| Qëllimi i modulit | Një modul që i pajis nxënësit me aftësitë për të kontrolluar pjesët e ndryshme të makinës larëse të rrobave, të gjejë defektet dhe ti riparojë ato . | |
| Kohëzgjatja e modulit | 85 orë mësimore | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Elektroteknik”. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Nxënësi riparon pjesët e komandimit të makinës larëse të rrobave Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja e mjeteve dhe e materialeve të punës sipas standarteve.- Analiza e skemes dhe evidentimi i elementeve të komandimit të makinës larëse të rrobave.- Kontrolli i çelesit të braves së derës.- Zëvendësimi i çelesit të braves së derës.- Kontrolli i elektrovalvulës së marrjes së ujit- Zëvendësimi i elektrovalvulës së marrjes së ujit- Kontrolli i paketës së komandimit (çelësi i ushqimit, çelësi i centrifugës, çelësi ekonomik etj)- Zëvendësimi i paketës së komandimit- Kontrolli i kuzhinetave- Ndërrimi i kuzhinetave me ekstraktor- Kontrolli i amortizatorëve të motorrit kryesor- Ndërrimi i amortizatoreve- Kontrolli i kondensatorëve- Zëvendësimi i kondensatorëve që kanë humbur vlerën ose janë tharë- Hartimi i preventivit për materiale sipas defektit të percaktuar- Kontrolli i punimeve të bera.- Korrigjimi i gabimeve të mundshme- Përgatitja e faturës për shërbimin e kryer- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit | |



